



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LIGJ
Nr.7/2024

PËR SHFUQIZIMIN E LIGJIT NR. 115/2017, “PËR KRIJIMIN E AGJENCISË
KOMBËTARE TË DIASPORËS”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,

V E N D O S I:

K R E U I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ligji nr. 115/2017, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, të ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij shfuqizohen.

Neni 2

Dispozita kalimtare dhe të fundit

1. Funkcionet, kompetencat, përgjegjësitë dhe detyrat e përcaktuara për Agjencinë Kombëtare të Diasporës do të vijojnë të kryhen nga kjo agjenci deri në krijimin/organizimin e institucionit/strukturës përkatëse përgjegjëse për to.
2. Nëpunësit civilë aktualë, punonjësit aktualë marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës, të Agjencisë Kombëtare të Diasporës trajtohen përkatësisht sipas dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil dhe Kodit të Punës në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit.



Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 25.1.2024.

Shpallur me dekretin nr. 47, datë 7.2.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

